

FATOS KONGOLI

VEPRA

GJEMIA E MBYTUR

ROMAN

15

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

VEPRA

1. Ne të tre - *roman*
2. I humburi - *roman*
3. Kufoma - *roman*
4. Dragoi i fildishtë - *roman*
5. Ëndrra e Damokleut - *roman*
6. Lëkura e qenit - *roman*
7. Te porta e Shën Pjetrit - *roman*
8. Jetë në një kuti shkrepësesh - *roman*
9. Në pritje të Nostradamusit - *tregime*
10. Karuseli - *roman*
11. Bolero në vilën e pleqve - *roman*
12. Iluzione në sirtar - *autobiografi*
13. Si-do-re-la - *roman*
14. Njeriu me fat - *roman*
15. Gjemia e mbytur - *roman*
16. Gënjeshtarë të vegjël - *roman*
17. Kapitulli i Amerikës - *autobiografi*
18. Stinë pandemie - *roman*
19. Misteri i mjellmës - *roman*
20. Ballo me maska ose shakaja e fundit - *roman*

FATOS KONGOLI
VEPRA

GJEMIA
E MBYTUR

roman

15

BOTIMET TOENA

Botim i veçantë në kuadër të Veprës.

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960535

© AUTORI dhe BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

1.

Rikthimi i tij qe i ngjashëm me zgjimin nga një gjumë i thellë. Ai u ndërmend ngadalë, pohim relativ ky, kuptimet “ngadalë” apo “shpejt” në këtë rast nuk kanë vend, koha dhe hapësira nuk ekzistonin për të, rrjedhimisht as derivatet e tyre. Pati vetëm një ndijim në një çast të caktuar, kur në terr ndodhi gëzueshëm shpërthimi i një pike, e më pas hapësira zuri të zgjerohej, siç besohet të jetë zgjeruar e vazhdon të zgjerohet pambarimisht universi. Në atë shurdhëri u ngrit një jehonë tingujsh, këta ia lanë vendin një zëri, dhe zëri zuri të përsëriste një kumt, një thirrje të ngulmët, dhe ai vendosi t’i përgjigjej thirrjes, dhe hapi sytë.

Fillimisht munda të vendosej në hapësirë. Më tej në kohë, meqë iu desh njëfarë kohe për të marrë me mend se ku ndodhej. E pa veten në një sallë me disa radhë ndenjësesh, ulur në skajin e njëres prej tyre, pranë një paretit të qelqtë nga dyshemeja në tavan, në rolin e murit anësor, me të ndara dritaresh. Përtej

këtij muri, jo fort larg, aq sa po të zgjatej mund ta prekte me dorë, sytë i zunë një avion të madh. Më tutje avionë të tjerë, të madhësive të ndryshme, të mbërthyer në vend apo në lëvizje dhe, edhe më tutje, avionë që ngriheshin nga pista për t'u zhdukur në horizont, apo e kundërta, që shkëputeshin nga fashat e reve në një cep të qiellit, për t'u ulur në pistë.

Ai qëndroi kështu, i përpirë nga peizazhi me avionë i asaj dite të mugët dhe trurin ia ngacmoi një pyetje. Ku ndodhej, pse dhe si ndodhej atje?

Pjesës së parë të pyetjes nuk e pati të vështirë t'i përgjigjej. Ndodhej në një aeroport, në sallën e një aeroporti. Të mbushur me njerëz, shumica ulur, të tjerë duke bredhur poshtë e përpjetë, ndonjëri duke vrapuar. Nisur nga ky fakt, u përpoq të fuste në përdorim logjikën. Përderisa ndodhej në një sallë aeroporti, të pranishmit s'mund të kishin qëllim tjetër veç të fluturonin për diku dhe ai, njëlloj si ata, s'mund të kishte qëllim tjetër veç të fluturonte për diku. Kjo lidhej pak a shumë me pjesën e dytë të pyetjes. Nga kishte ardhur dhe ku shkonte? Kush ishte ai vetë?

I paaftë të gjente përgjigjet e duhura, ai u mjaftua të rrinte pa lëvizur, me përshtypjen se dikush, ndoshta në një nga ndenjëset e sallës, e përgjonte. Ideja e të qenit i përgjuar zuri ta bezdiste dhe ai ndërmori një veprim automatik. Futi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës

dhe nxori prej andej një pasaportë e, bashkë me pasaportën, një biletë avioni.

Dyshimtar, vështroi përreth. Veprimi për të futur dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës nuk duhej të kishte qenë dhe aq automatik. Duhej të kishte qenë i komanduar, me një qëllim qartazi të lexueshëm, domethënë ta shtynte të zbulonte pasaportën dhe biletën ku përmbledhej enigma e tij.

Pa ndonjë emocion, ai u përqendrua te kapaku i pasaportës. Aty mori informacionin e parë përmes shënimit “Republika e Shqipërisë”, në krye të kapakut. E lexoi dhe e kuptoi natyrshëm, siç lexoi dhe kuptoi natyrshëm dublimin “Republic of Albania”. Megjithëse i ndjeu njëlloj familjare të dyja gjuhët, mbërriti në përfundimin e konfirmuar në të dyja gjuhët se duhej të ishte nga Shqipëria, domethënë shqiptar, po të pranonte se pasaporta që mbante nëpër duar i përkiste atij.

Gjithnjë pa ndonjë emocion, ai kaloi në faqen pasardhëse, në krye të së cilës përsëritej informacioni i kapakut dhe në anën e prapme të saj, nga një fotografi me ngjyra, e vështroi një tip me flokë e sy të zinj. Një copë herë mbeti si i hipnotizuar, i zhytur në sytë e tjetrit. Ky as reagoi, as e mori mundimin t’i sqaronte ndonjë gjë, derisa burri u shkund, disa të dhëna elementare rreth tipit shënoheshin në po atë faqe. Në bazë të tyre ai quhej Glauk Fusha, lindur në Tiranë, më 14 dhjetor 1972.

Këto e ca hollësi të tjera pa ndonjë rëndësi për të, fjala vjen data e lëshimit të pasaportës, ajo e skadimit, organi që e kishte lëshuar etj., i konfirmonte vetë personi me një firmë të lexueshme emër e mbiemër poshtë portretit. Pra, po të pranonte se pasaporta i përkiste atij, personi i fotografisë duhet të ishte ai vetë.

Ca veprime të mëtejshme i kreu po aq spontanisht - fjala më e përshtatshme në rastin e dhënë - sa ç'kishte qenë spontane futja e dorës në xhepin e brendshëm të xhaketës për të nxjerrë pasaportën dhe biletën e avionit, së cilës aty për aty nuk i kushtoi vëmendje. U ngrit në këmbë, i vuri pasaportën dhe biletën në xhepin e brendshëm të xhaketës, u kujdes të merrte në ndenjësen aty pranë një xhup dimëror prej lëkure të zezë dhe, mbështetur në anë të ndenjësës, një valixhe të vogël nga ato me rrota, pa e vënë aspak në dyshim se sendet ishin të tijat. Pastaj këmbët e çuan drejt një salloni llamburitës, ku u ndie në një mjedis të njohur falë një përvoje kohësh të shkuara.

Me tërheqësen e valixhes në njërën dorë dhe xhupin në tjetrën, ai mbeti në sallon midis turmës së njerëzve, në një orvatje për t'i dhënë kuptim konkret përfytyrimit "kohë të shkuara". Hoqi dorë ja ngaqë shtrydhja e trurit i krijoi marramendje, ja ngaqë urgjenca e tij e vërtetë ishte edhe më konkrete, të provonte nëse portreti i fotografisë së pasaportës i përkiste atij. Kjo përkoi me një urgjencë të re, të një natyre po themi njerëzore: i erdhi të urinonte.

Falë përvojës së kohëve të shkuara - gjemi e mbytur thellësive, që lëshonte ndonjë sinjal, kaq mundi të abstragonte - ai u orientua në sallonin llamburitës përmes shenjave konvencionale të vendosura gjithandej, derisa gjeti një shenjë WC-je.

Tipi i pasaportës iu shfaq në pasqyrë tek lante duart pasi urinoi. Originali i pasqyrës ishte disi i ndryshëm nga kopja e fotografisë. Sytë dhe flokët nuk i kishte aq të zinj, mund të quheshin gështenjë, por fytyra mbetej po ajo, e rregullt dhe, ndryshe nga kopja, që tërë kohën e kishte vështruar me një seriozitet të rëndë, i buzëqeshi. Një lloj ngushëllimi për të, e tmerrshme të ishte aq marrëzisht serioz sa portreti i fotografisë. Sepse nuk i mbeti asnjë dyshim, ndodhej përballë vetvetes, pasaporta i përkiste atij, ai quhej Glauk Fusha, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 14 dhjetor 1972.

“Mirë, mendoj, duke iu drejtuar më shumë vetvetes në pasqyrë. Po e pranoj, jam i detyruar ta pranoj, quhem Glauk Fusha, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 14 dhjetor 1972. Po ç’del nga kjo? Ç’lidhje kam unë me këtë emër të çuditshëm, shtetësinë, ditën dhe vendin e lindjes, e kushedi çfarë të tjera, që ende nuk i di? Ç’lidhje kam edhe me ty zotëri, që më buzëqesh kot më kot? Jo, e padrejtë të pranoj qorrazi disa gjëra vetëm sepse gjeta në xhepin e xhaketës një pasaportë, pa e ditur se si u ndodh në xhepin tim, kush e ka futur dhe

për ç'arsye. Me ç'kam dëgjuar, s'më kujtohet se kur e se ku, sot një sport i përhapur në univers qenka falsifikimi dhe trafikimi i pasaportave, me fjalë të tjera trafikimi i identiteteve. S'ka të bëjë me pëlqimin apo mospëlqimin tim, është diçka parimore!”

Ai ngriu përballë vetvetes, që kishte mundur të formulonte fjalët “s'më kujtohet”. I befasuar nga ideja e trafikimit të pasaportave apo e identiteteve, që nuk e mori vesh se si i mbiu në tru. I paqartë për atë që e kishte quajtur diçka parimore. Të gjitha këto as i njihte, as i ndiente.

I ktheu shpinën pasqyrës, iu vodh shëmbëllimit të tij dhe doli sërish në sallonin llamburitës, duke tërhequr me një rën dorë valixhen, xhupin në dorën tjetër. Grumbuj njerëzish nguteshin të shkonin për diku, në drejtime të ndryshme, disa dilnin nga dyqanet, disa futeshin, të tjerë prisnin nëpër tryezat e lokaleve ose në radhët para banakëve.

Ishte gati të vinte një bast. Lëvizjet e tyre, të rrëmujshme në pamje të parë, të ngjashme me lëvizjen brouniane të molekulave të një lëngu - imazh i beftë - duhej të drejtoheshin nga një vullnet përtej tyre. Ky do të ishte edhe shpjegimi më i arsyeshëm i lëvizjeve të tij, çka i impononte të mësohej me identitetin e tij, të trafikuar ose jo, ta pranonte, sido që të ishte. Në humnerën e errët të kujtesës, tashmë nuk i mbetej gjë tjetër veç t'i bindej një vullneti të epërm, okult dëshiroi ta quante. Në përputhje

me këtë ai shkoi dhe zuri vend në të njëjtën ndenjëse pranë paretit të qelqtë, përtej të cilit dremiste në pistë avioni i madh. Atje mundi të bënte edhe një zbulim të ri.

Sapo zuri vend në ndenjëse, futi dorën në xhepin e brendshëm të xhaketës prej nga nxori pasaportën dhe biletën e avionit. Tashmë, tek vërtitej nëpër sallon, i kishte rënë në të, ndodhej në aeroportin e Vjenës. Ky fakt, ndonëse nuk e përcaktoi dot se kur kishte qenë këtu për herë të fundit dhe nga kishte ardhur kësaj here, i injektoi një dozë shprese, gjemia e mbytur jepte sinjale. Kjo e shtyu të shfletonte pasaportën për të gjetur ndonjë shënim në dogana aeroportesh të tjerë. Nuk gjeti asgjë, asnjë vulë. Atëherë iu kthye biletës. Një shikim i mundësoi të mësonte disa hollësira, fjala vjen numrin e avionit, orën e fluturimit, portën ku duhej të paraqitej dhe, më impresionuesen, datën e asaj dite: 14 dhjetor 2014. Burrit iu desh njëfarë kohe të kapte domethënien e shifrës. Ajo përmbante ditëlindjen e tij, 14 dhjetor. Një llogari elementare e çoi në përfundimin se kishte lindur plot dyzet e dy vjet të shkuara!

Ai u mbështet në shpinë të ndenjësës. Përputhja e datës së lindjes së tij dyzet e dy vjet të shkuara me datën e asaj dite, nuk ishte e rastit, logjika nuk ia pranoi. Përputhja tingëllonte e kërkuar. Pa dyshim, një vullnet i epërm okult po e shtynte në një eksperiment. Me ç'qëllim? Një instinkt i mbetur në kushedi

ç'kasafortë të gjemisë së mbytur, e paralajmëroi, nuk duhej të futej qorrazi në rrugë pa krye. Të tërhiqej, të mos lejonte të manipulohej më tej, të rikthehej në errësirën prej nga kishte dalë. Në këtë orvatje, mbështetur në shpinë të ndenjësës, ai mbylli sytë.

Nuk e mori vesh se sa qëndroi ashtu, symbyllur, madje edhe u përumb, por vetëm përkohësisht. Në shurdhërinë e verbër u ngrit një erë, hapësira u mbush me jehona, veshët i oshtinë, au-au-au... Këto ia lanë vendin një zëri, dhe zëri përsëriste një kumt, një thirrje të ngulmët, dhe ai e pati të pamundur të mos i përgjigjej, dhe hapi sytë.

Njerëzit që deri para disa çastesh - një minutë? një orë? një shekull? - mbushnin ndenjëset aty rrotull, ishin zhdukur. Në atë braktisje i mbërriti një zë femëror me thirrjen se udhëtari i quajtur Glauk Fusha duhej të paraqitej sa më shpejt në portën G-31.

- Është thirrja e fundit, - theksoi zëri, - udhëtari Glauk Fusha të paraqitet te porta G-31.

Ai u kthjellua, thirrja i drejtohej atij. Pra, duhet të paraqitej sa më shpejt te porta G-31, e këtë ia zunë sytë përballë, jo fort larg. Duke tërhequr valixhen me një rën dorë dhe xhupin në tjetrën, ai u ngut të shkonte drejt portës G-31. Dy gra, njëra e bardhë, e gjatë dhe e hollë, tjetra e zezë, e shkurtër dhe trashaluke, të veshura me uniformë aeroporti, i kërkuan

pasaportën dhe biletën. Ai futi dorën në xhep, i nxori të dyja, ia dha të bardhës. Kjo u hodhi një vështrim, ia tregoi koleges me ngjyrë, pastaj gratë zunë ta shihnin me kureshtje, duke shkëmbyer njëkohësisht me njëra-tjetrën ca vështrime të çuditshme. Në fund i buzëqeshën. Një buzëqeshje jo fort e zakonshme, kështu iu duk atij. Dhe i uruan rrugë të mbarë.

Burri bëri një përpjekje të dytë për t'u rikthyer në errësirën nga kishte dalë kur avioni mbërriti në pistën e fluturimit, u derdh përpara dhe, ndërsa gjithçka mbetej pas rrufeshëm, mbylli sytë. Me shkëputjen e rrotave nga toka, mbetën prapa edhe dridhjet, edhe zhurmat, ai pati ndjesinë e një dore që e përfshiu, e ngriti peshë, në bord ra një heshtje ankthi dhe në atë heshtje shpresoi të ikte.

Errësira e ktheu mbrapsht. Një dritë verbuese i ngacmoi sytë, ai u detyrua t'i hapte: nga dritarja e avionit pa se po fluturonin sipër reve.

- E kotë, - tha me vete tek shihte qiellin, - jam i pafuqishëm, s'mund të ndryshoj asgjë!

I ndërgjegjshëm për çka po bënte, ai futi dorën sërish në xhepin e brendshëm të xhaketës, nxori prej andej pasaportën dhe e hapi. Kopja e fotografisë e mbërtheu me vështrimin e rëndë.

“Nuk është nevoja për kaq shumë seriozitet, i foli ai. Dhe mos u fyej që po të drejtohem

kështu, të pranoj pa ndonjë entuziazëm që ti je unë dhe unë jam ti, po të mos vërej se entuziazmi nuk hyn fare në këtë mes. Për ty gjërat janë të thjeshta, të qarta. Quhesh Glauk Fusha, shtetas shqiptar, ke lindur në Tiranë, më 14 dhjetor 1972. Meqë data e sotme është 14 dhjetor 2014, i bie që sot ti të kesh ditëlindjen, mbush plot dyzet e dy vjeç. Unë s'dua t'i vë në dyshim këto, por ama të përkasin ty, jo mua.

Në pasaportën tënde - mund të quhet edhe imja përderisa më është dhënë në përdorim - nuk figuron kurrfarë shënimi. E habitshme, as personalitetet më të njohura të planetit, as mafiozët më të rrezikshëm, po të marrim si shembull vetëm këto kategori, vështirë se do të lëviznin kështu nëpër botë. Ti duhet të jesh tepër special. Unë duhet ta quaj veten me fat që më krijohet privilegji të vishem me attribute kaq speciale. Megjithëse, të jetë e qartë midis nesh, unë nuk jam ti dhe ti nuk je unë, për një mijë arsye ku s'dua të zgjatem. Kryesorja, ti e di nga vjen, ku po shkon dhe përse; unë s'di as nga vij, po të mos jetë kjo një errësirë pa anë e pa fund, as ku shkoj, as përse.

Në këtë mes ka një kontradiktë logjike. Në fakt, ne po udhëtojmë bashkë, në të njëjtin avion, unë i ulur në ndenjësen pranë ditares, përtej së cilës më lëbyr sytë një diell i fortë, ti i fshehur në faqet e pasaportës... Ah, një rastësi, ma shtiu në mendje ky diell i fortë. Sot është

e diel, pra takimi ynë po ndodh në një ditë të diel. Me këtë rast të propozoj një marrëveshje. Emrin Glauk të pasaportës mbaje, s'mund të bësh pa të në asnjë doganë. Edhe të tjerët atje ku po shkojmë, kështu duhet të të njohin, me këtë emër, pra nuk ke si i shpëton, të pëlqen ose jo. Por unë do të të quaj ndryshe, bazuar në një histori të vjetër leximesh në kohëra të dikurshme, të mbyllura hermetikisht në kasafortën e një gjemie të mbytur.

Ç'është kjo gjemi? Lëre, të thashë, nuk ia vlen të zgjatemi, bën pjesë në ato një mijë arsytet për të cilat unë nuk jam ti dhe ti nuk je unë. Shkurt, meqë sot është e diel, bazuar tek ajo historia e leximeve të dikurshme, për analogji, po të quaj Diell... Pra, Diell, gëzohem pa ndonjë entuziazëm që u takuam..."

Atë e shkundi befas një zë i butë femëror, i ngjashëm me zërin që e kishte nxjerrë nga humnerat e hiçit në sallën e pritjes së aeroportit. Ai ngriti kokën. Një stjuardesë, me fytyrë të pastër e flokë biondë të mbledhur topuz, po i buzëqeshte. Ajo nuk po i bënte thirrje për t'u paraqitur sa më shpejt te porta G-31. Ajo po e pyeste se çfarë dëshironte të pinte, dhe ai e vështroi i hutuar. Në qoftë se nuk i duhej të paraqitej sa më shpejt te porta G-31, i duhej t'i jepte një përgjigje gruas së re, pra ç'dëshironte të pinte, dhe ai u ngut së pari të fuste në xhep pasaportën, më tej t'i drejtonte asaj kërkesën për një gotë ujë.

Gjithnjë e buzëqeshur, stjuardesa i mbushi me ujë një gotë plastmase, ia zgjati, pastaj duke shtyrë karrocën e shërbimit, u largua nëpër korridorin e bordit. Atëherë ai vërejti se në radhën e tij, me tri ndenjëse, dy të tjerat ishin bosh.

Duke parë vendet bosh, i lindi një ide. Ta ftonte Diellin të shkëputej nga fotografia e pasaportës, të vinte të ulej pranë tij, në njërën nga ndenjëset, ku të donte. Të porosiste diçka për të pirë, në mos ujë, një gotë verë. Me perspektivën joshëse të një bisede përpara një gote me verë, Dielli do ta pranonte ftesën.

Ai nuk e pranoi, ndenjëset pranë tij mbetën bosh.

“Si të duash, - i tha, - në daç eja, në daç rri aty ku je. Mua, përderisa dështova në orvatjet për të mos e vazhduar këtë rrugë, më duhet të vendos disa piketa. Tani që u takuam bashkë, çështja shtrohet ndryshe, s’ka rëndësi kush jam, nga vij e ku shkoj. Kjo për një arsye, po e quaj formale, që në të vërtetë nuk duhet të jetë dhe aq formale. Ta zëmë se në xhepin e xhaketës nuk do të kisha gjetur pasaportën me të dhënat e tua, që dëshmojnë se je shqiptar, por një pasaportë tjetër, me të njëjtin portret ose jo, nuk është thelbësore. Puna do të ndryshonte nëse portreti yt do të shoqërohej me të dhëna të tjera, pra me një tjetër vendlindje, me tjetër shtetësi apo kombësi, për shembull lindur në X fshat apo

qytet të Norvegjisë, Britanisë së Madhe apo të Francës e kështu me radhë, s'po them në X fshat apo qytet të Burundit, s'ke të dhëna për të qenë afrikan. Cili do të ishte ndryshimi dhe ç'rëndësi kanë këto?

Temë e ngatërruar, ndoshta do të kemi rast ta diskutojmë. Për mua tani është e rëndësishme të mësoj një gjë: kush je ti dhe me çfarë merresh?

Dakord, po sillem me një dykuptimësi që të ngjall dyshime, rrjedhimisht të mos i besosh pohimet e mia. S'më mbetet qejfi. Këto pohime, quaji përçartje po të duash, më provojnë edhe mua vetë se në një jetë tjetër duhet të kem qenë i përçartur. Ç'është kjo jetë tjetër? Nuk e di. Ndoshta po udhëtoj në këtë avion për të zbuluar se cila ka qenë jeta ime e dikurshme dhe shpresoj në mirëkuptimin tënd... Eja të flasim, jo rastësisht po udhëtojmë bashkë, dikush po na manipulon. A beson ti në atë teorinë sipas së cilës njerëzimi, në veçanti çdo qenie njerëzore, manipulohen nga një vullnet i epërm okult?"

Më kot priti të merrte përgjigje. Po të merrte ndonjë përgjigje, edhe negative, domethënë sikur tjetri t'i kundërvuhej, s'do t'i bëhej vonë. Ai ndiente nevojë të fliste, të shtjellonte mendime, çfarëdo qofshin, edhe pa lidhje me objektin e bisedës, aq më pak me teorinë e manipulimit të qenieve njerëzore nga një vullnet i epërm okult. Për shembull, do të kënaqej po të mësonte se

në atë që e kishte quajtur jetë tjetër, kishte ushtruar profesionin e pianistit. Hamendje e çuditshme. E nxitur ndoshta nga një rrjedhje mbresash pa inventar. Jehona të një filmi kushtuar një pianisti të famshëm në kohën e Luftës së Dytë Botërore të shekullit të kaluar, në një vend emri i të cilit nuk iu kujtua, vepër e një regjisorit edhe më të famshëm, emri i të cilit gjithashtu nuk iu kujtua. Për kompensim, iu kujtua një hollësi fort e veçantë; ai regjisor i famshëm kërkohet nga drejtësia amerikane, po të binte në duart e saj rrezik të hante një dënim të rreptë me burg për shkak të përdhunimit të një vajze minorene.

Kjo rrjedhje në tru i krijoi një dyshim. Po sikur për arsye të së njëjtës natyrë, nëse jo përdhunim minoreneje diçka tjetër, fjala vjen një vrasje, e qëllimtë ose aksidentale etj., ai të kërkohet në Shqipëri nga drejtësia dhe tani fluturonte për atje, duke shkuar me këmbët e veta si çjapi te kasapi?

U mbështet pas dritares në një përpjekje për t'u çliruar nga pandehma të tilla ogurzeza. Sipër hapej në të katër anët e horizontit një qiell i kthjellët, sytë ia vriste dielli i fortë, poshtë shtresoheshin fasha reshë.

“Gjemia ime e mbytur, mendoi, duhet të ndodhet përtej këtyre reve, atje ku ato prekin fundin. Unë jam duke shkuar në kërkim të gjemisë sime të mbytur.”

Ky iu duk zbulimi më i rëndësishëm që kishte bërë pas daljes nga errësira e hiçit. Për

një kohë të gjatë mbeti duke vështruar përtej dritares, me përshtypjen sikur fluturimi në hapësirën midis qiellit dhe reve do të vazhdonte pa mbarim. Por s'kaloi shumë dhe avioni u zhyt midis reve, zuri të tundej, të kërcente, si një makinë që ecën me shpejtësi në një rrugë të keqe, plot gropa, për t'u zhvendosur në një hapësirë të mugët, ku në fillim nuk shqoi asgjë veç pikave të shiut në dritare. Ca nga ca u ravijëzuan konture malesh, mugëtira lejoi shfaqjen e një peizazhi të përmbytur. Ndryshe nga ç'kujtoi ai, avioni u orientua lehtësisht për të gjetur pistën në atë peizazh të përmbytur.

“Ndoshta e gjej edhe unë një pistë”, tha me vete.

Para se të vihej në radhë me të tjerët për të dalë nga avioni, tek vishte xhupin, i drejtoi Diellit një thirrje. T'i linte meritë, të mos fshihej. Praninë e tij e ndiente si ajrin që thithte, e pakuptimtë kjo sjellje.

- Ose eja ta vazhdojmë rrugën bashkë, - i tha, - ose më lër të qetë, ti në punën tënde, unë në timen.

Dielli e la të qetë në autobusin ku hipën si zbritën nga avioni. Pranë godinës së aeroportit ai duket u ngut të largohej dhe humbi i përzier me turmën.

Sido që i bëri sytë katër ta shihte, nuk e pa gjëkund, as brenda godinës së aeroportit, ku njerëzit u dyndën drejt pikave të kontrollit. Ai s'kishte ndonjë arsye të dyndej. Në xhep

vërtet mbante një pasaportë që dëshmonte identitetin e tij, por kjo mbetej relative. Punët ndërlikoheshin veçanërisht nëse, në ikje e sipër, Dielli kishte marrë me vete edhe fotografinë e dokumentit.

Nuk e kishte marrë, fotografia ndodhej në vend. Tani, pavarësisht mospërputhjeve për shkak të disa hollësive si ngjyra e zezë e flokëve apo syve, e ndryshme nga ngjyra gështenjë e flokëve dhe syve të tij, mbi të gjitha një seriozitet i rëndë i portretit të tjetrit, aspak në natyrën e tij, i duhej ta pranonte, tipi i fotografisë dhe ai vetë ishin i njëjti person. Në këto kushte, gjatë kohës që iu desh të priste në radhë për të mbërritur te sporteli i oficerit të doganës, e sulmuan një varg pikëpyetjesh. Jo aq lidhur me mospërputhjet e mësipërme, në njëfarë mënyre të shpjegueshme, përderisa bëhej fjalë për fotografi dhe çdo gjë varej nga cilësia e fotografisë apo nga gjendja shpirtërore e të fotografuarit në çastin e dhënë. Ai nuk do të ishte i aftë të jepte sqarime nëse personi zyrtar do ta pyeste, për shembull, se si e përligjte mungesën në pasaportë të çdo lloj shënimi në doganat e vendeve prej nga vinte. Pa përjashtuar hamendjen e skajshme, domethënë variantin e të qenit i shpallur në kërkim nga policia shqiptare ose Interpoli për kush e di se çfarë krimesh.

“Të dalë ku të dalë, mendoi. Më e shumta, do të më arrestojnë, në mos më kthefshin